**Republika e Kosovës**
**Komuna e Drenasit**
**Kuvendi i Komunës**

Nr.12/060/3- 27501 dt. 24/07 2020

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Labinot Halilaj, më datë: 30/07/2020 (e Enjte ) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kulturës të Komunës.

**THËRRET**
**MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS**

Mbledhja do të ketë këtë:

**Rend dite:**

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.06.2020.
2. Propozim Vendim për shpalljen e Lokalitetit të Boshtrës ( FORSYTHIA EUROPEA) në zonën e Goleshit- Fshatin Sankoc në Kategorinë- Monument i Natyrës, (e plotësuar).
3. Propozim Vendim për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028, (e plotësuar).
4. Njoftim rreth përfundimit të kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit .
5. Propozim Vendim për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale në Komunën e Drenasit .
6. Propozim Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.12-353-22880,të datës 29.06.2020 për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive, në pronën komunale, në zonën kadastrale në Abri e Epërme dhe në zonën kadastrave në Zabel i Epërm.
7. Propozim Vendim për këmbimin e parcelave në zonën kadastrave në Baicë.
8. Propozim Vendim për lirim nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2020.
9. Propozim Vendim për caktimin e Lokacioneve për ndërtimin modernizimin dhe kompletimin e infrastrukturës përcjellëse të studionit të qytetit ''Rexhep Rexhepi" në Poklek të Ri.
10. Propozim Vendim për caktimin e Lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e Çerdhes në Komoran.
11. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm Publik për kthimin e pronave të cilat janë nën menaxhimin e AKPS-së, në zonat Kadastrale : Qikatovë e Re, Terstenik,Poklek , Korroticë e Poshtme, Zabel i Poshtëm, Komoran dhe Sankoc.
12. Raporti Financiar i Zhvillimit të Buxhetit Janar Qershor 2020.
13. Për Shpalljen e interesit të Përgjithshëm Publik të pjesës së ngastrës kadastrave 120/0, për zgjerimin, modernizimin dhe kompletimin e infrastrukturës përcjellëse të Stadionit në qytetin e Drenasit " Rexhep Rexhepi" në Poklek të Ri.
14. Të ndryshme.

Drenas, 24.07.2020

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj

Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

12Nr.060/64 26276 dt.17.07 2020

**Mbledhja e rregullt**
**Kuvendi Komunal**
**29. 06.2020**

**PROCESVERBALI**

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë: **29.06.2020**
**Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues**
**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 28, anëtarë.**
Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 27.05.2020.\
2. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KB „Feronikeli".
3. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KF„Drenasi".
4. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KV„Feronikeli".
5. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KH„Drenica".(M).
6. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KF„Feronikeli".
7. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për SHKA„Shote Galica".
8. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për OJQ„Shqipet e Drenicës".
9. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për projektin e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL)-Drenas .
10. Njoftim rreth përfundimit të kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit.
11. Propozim Vendim për miratimin e planit zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028.
12. Draft - Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023.
13. Propozim Vendim për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrave.
14. Propozim Vendim për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive, në pronën komunale, në parcelën 2048/0 e cila është në zonën kadastrale në Abri e Epërme dhe parcelën 235/0 e cila është në zonën kadastrale në Zabel të Epërm.
15. Propozim Vendim për ndryshimin e anëtarëve të KKSB-së.
16. Të ndryshme.

*Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 29 /06/ 2020 ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Nënkryetari i Komunës Nazmi Hasi, kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, drejtorët e Drejtorive përkatëse dhe përfaqësuesit e Kforit.*

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj**: deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Kuvendit pasi përshëndeti të pranishmit, i njoftoi me rendin e ditës anëtarët e kuvendit se kemi edhe një pikë shtesë për rendin e ditës, ku dhe jeni të njoftuar me materialin a ka dikush diçka.

1. Propozim Vendim për ndryshimin e anëtarëve të KKSB-së.

**Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj** hedhim në votim rendin e ditës me një pikë shtesë ku rendi i ditës u votua në mënyrë unanime.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1.** Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. **27.05.2020.**
Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit** - hodhi në votim pikën e parë të rëndit e ditës,e cila u votua në mënyrë unanime.

*Kaloim te pika e dytë e rendit të ditës: 2.* Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KB „Feronikeli". Ka diskutime

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj** *; kaloim te pika e tretë e rendit të ditës: 3.* Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KF„Drenasi".

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit -** hodhi në votim pikën e tretë të rëndit e ditës,e cila u votua në mënyrë unanime.

*Kaloim te pika e katër e rendit të ditës: 4.* Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KV„Feronikeli".

**Sokol Bylykbashi** –përshëndetje për të gjithë sigurisht që edhe unë i përkrahi këto propozim vendim por e kam një vërejtje lidhur me mungesën e raporteve se si janë shpenzuar këto mjete financiare nga këto klube dhe nuk e di pse deri me tani nuk ka edhe pse këtë çështje e kam parashtrua edhe vitet para parke sepse edhe raporti i auditorit kur është ber ka dal qe nuk keni pas raporte kjo është vërejtja ime.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**-nuk është e vërtet që auditori ka thënë që nuk kemi raporte,dhe me gjej dhe me dokumento për këtë punë,sepse raportet ekzistojnë ,komisionet vendosin dhe komisionet i posedojnë të gjitha raportet.

**Sokol Bylykbashi**-është e vërtet kryetar unë e kam lexuar vet,po me duket që është në kohën e qeverisjes së kryetarit tjetër kështu që mos thuaj qe nuk është e vërtet unë nuk e përmenda qeverisjen tënde as vitin,vetëm thash që kam lexuar një raport vitin nuk e di nuk e mbaj mend mirëpo ajo që thash qëndron.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**- tani pajtohem me ty sepse për qeverisjen para pes viteve unë nuk e di si ka qenë ,unë flas vetëm për qeverisjen time.

**Drejtoresha Për Kulturë Rini dhe Sport Shqipe Zogu**-për secilin përfitues të subvencioneve është e obligume me rregullore që e kemi zotuar në vitin e kaluar me u bërë raportet narrative dhe raportet kthyese maksimumi brenda 30 ditë prej momentit kur përfundon projekti ose shuma për të cilën i ka përfitu OJQ-ja në fjalë, për me ju njoftua me saktë rregullore që e kemi zotuar në vitin e kaluar edhe këtë vit ne si DKRS na obligon të caktojmë një zyrtar monitorues për se cilin projekt,edhe ne vitin e kaluar kemi angazhua disa mbi kqyress për se cilin projekt dhe këta zyrat përveç që e kanë monitorua procesin e shpenzimit të parasë publike në këtë rast subvencionit kanë raportuar dhe kanë hartu raportin me shkrim për secilin përfitues duke u bazuar në monitorimin që e kanë bërë në raportet narrative që kan kthyer OJQ-t ,dhe raportet financiare dmth ne si DKRS posedojmë raport financiar specifik për secilin dhe është i publikuar në ueb faqen e komunës dhe është i qaseshem për të gjithë për kë do qe ka interesim me shiku këtë raport.

**Adem Bucolli** -përshëndetje për te gjithë unë po flas në emër të KF„Feronikelit"ne për çdo kërkesë për subvencion sjellm raport të detajuar të shpenzimeve dhe me plot përgjegjësi po të them që as 2% të shpenzimeve totale nuk i mbulon komuna ndërsa komuna e Prizrenit dhe komuna e Prishtinës deri 50 -60% i mbulojnë shpenzimet ,pasi jemi ne këtë temë kisha pasur edhe një kërkesë dhe le të mbetet në seancën e radhës që të sjellën raportet e secilit klub dhe atëherë ne bashkërisht edhe me kryetarin e komunës të rrisim buxhetin e DKRS-së për subvencionim me të madh,dhe e hartojmë një plan për me rrit buxhetin.

**Sabrije Kukaj** -po e shoh se këtu ka klube sportive ,OJQ, dhe SHKA SHOTE GALICA por spo e shoh edhe shoqatën për drejtat e grave dhe fëmijëve që është këtu që operon këtu,ndërsa drejtorit tjera nga subvencionet e drejtorive tjera duhet ta keni parasysh këtë shoqatë sepse vitin e kaluar ne i kemi ndarë 5000€ subvencion për këtë shoqatë në emër të drejtorisë se Bujqësisë dmth me kanë ajo projekt në emër të drejtorisë se Bujqësisë ,por nuk i ka marr asnjë here dhe asnjë sqarim nuk i kanë dhënë se nuk i kanë marr parat dhe kisha dashtë me mbështet me subvencione te tjera sidomos ne drejtorin e Bujqësisë apo ndonjë tjetër drejtori që ka subvencione.

**Drejtoresha Për Kulturë Rini dhe Sport Shqipe Zogu**-në DKRS të gjithë ata që kanë aplikuar këtë vit janë subvencionuar,kemi pas fat që kemi pasur një rritje me të madhe të buxhetit prej 20.000€ në krahasim me vitin e kaluar në këtë rast OJQ-ja në fjalë nuk ka aplikuar thirrja për aplikim ka qenë një muaj e qaseshme 15 ditë punë pa llogaritur ditët e pushimit dhe kanë pas të drejt të aplikojnë ë të gjitha ato OJQ veprimtaria e tyre që ndërlidhët me aktivitete kulturore sporte ose ndonjë arti zanat por nuk ka aplikuar .ndërsa në pyetjen qe e keni bërë në lidhje me subvencionimin nga ndonjë drejtori tjetër nuk e kam kompetencën të flas ,edhe një herë të gjithë ata që kanë aplikuar janë subvencionuar dhe në afatin prej 5 ditësh që është për drejt ankese nuk kemi pabanuar asnjë ankesë kështu që procesi ka shkuar në rregull dhe nuk ka pasur vërejtje

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit** - hodhi në votim pikën e katërt të rëndit e ditës,e cila u votua në mënyrë unanime.

*Kalojmë te pika e pestë e rendit të ditës: 5.* Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KH„Drenica".(M).

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit** - hodhi në votim pikën e pestë të rëndit e ditës,e cila u votua në mënyrë unanime.

*Kalojmë te pika e gjashtë e rendit të ditës: 6.* Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KF„Feronikeli".

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit** - hodhi në votim pikën e gjashtë të rëndit e ditës,e cila u votua në mënyrë unanime.

*Kalojmë te pika e shtatë e rendit të ditës: 7.* Propozim Vendim për Financimin e Projektit për SHKA„Shote Galica".

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit** - hodhi në votim pikën e shtatë të rëndit e ditës,e cila u votua në mënyrë unanime.

*Kalojmë te pika e tetë e rendit të ditës: 8.* Propozim Vendim për Financimin e Projektit për OJQ„Shqipet e Drenicës".

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit** - hodhi në votim pikën e tetë të rëndit e ditës,e cila u votua në mënyrë unanime.

*Kalojmë te pika e nëntë e rendit të ditës: 9.* Propozim Vendim për Financimin e Projektit për projektin e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL)-Drenas .

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit** - hodhi në votim pikën e nëntë të rëndit e ditës,e cila u votua në mënyrë unanime.

*Kalojmë te pika e dhjetë e rendit të ditës:* 10. Njoftim rreth përfundimit të kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit.

**Fjalën e merr drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër z. Ruzhdi Lestrani -** të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Drenasit, duke pasur për bazë Ligjin Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, respektivisht nenin 23 paragrafin 1 dhe 2, ju njoftoj si në vijim:
Komuna e Drenasit gjatë viteve paraprake ka lidhur disa kontrata për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cilave kontrata ju ka skaduar afati i shfrytëzimit, andaj ashtu siç me obligon legjislacioni në fuqi po ju njoftoj me ato prona:
Kontrata e lidhur me datë 13/05/2010, me nr. 465-1036, me sipërfaqe 0.10.00 ha, e cila është pjesë e ngastrës nr. 1/8, në Zonën Kadastrale në Komoran.
Shfrytëzues i përkohshëm (10 vite) ka qenë N.SH "EURO-B-LAB" me Sala Shala-Gjoshi nga fshati Sankoc.

Duke mos pasur asnjë mundësi të vazhdimit të tyre, sepse një gjë të tillë e ndalon neni 23 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i cili thotë: Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës, në këtë formë duke mos lejuar asnjë vazhdim të asnjë kontrate, pa marr parasysh investimet e bëra nga personat që e kanë pasur në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale.
Sa për informacionin tuaj, në lidhje me këtë çështje i kemi shkruar edhe Ministrinë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ku i kemi kërkuar sqarime se si të veprojmë, e njëjta është përgjigjur se të gjitha pronat e dhëna në shfrytëzim pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratë i kthehen komunës.
Andaj, prona e lartcekura, edhe në bazë të listës së veçantë, ashtu siç e parasheh neni 13 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nuk është paraparë që të epet në shfrytëzim për këtë vit, po ashtu kjo parcelë do të vlerësohet nga ana e Komunës së Drenasit, se e njëjta a do të epet në shfrytëzim apo do të shfrytëzohet për interesat e Komunës së Drenasit, gjithnjë në përputhje me planin zhvillimor ekonomik të Komunës sonë.
Bashkangjitur gjeni kërkesën nga Komuna e Drenasit, si dhe përgjigjen e MAPL-së Nr. 463-32, të datës 10.01.2020.

**Vehbi Berisha-**në lidhje me këtë çështje vet ligji është shumë i qartë dmth prona duhet ti kthehet komunës,po pyetja ime konkrete është a duhet ne doemos të presim një vit derisa të bëjmë një zgjidhje për shkak së tek shkresë a që e ka thyer MAPL-ja thotë që komuna obligohet të jap një propozim vendim kuvendit në këtë rast,unë mendoj që ajo zonë është me interes shumë të lart ekonomik për shkak se është buzë magjistrales dhe kishte me kriju shumë të hyra edhe për komunën.
**Kryetari komunës Ramiz Lladrovci-**ne më ligj e kemi detyrim çdo pronë që këna me bërë shpallje për ate pronë duhet një vit për para ose data e fundit është 31.12 i vitit paraprak para se me hyre në vitin e ri kështu që ne nuk kemi pas drejt me e shtinë në listë një vit përpara një pronë të cilës i ka dal afati kështu qe për pronë vendos kryetari i

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj,** a ka dikush diçka, rreth njoftimit pra **kalojmë te pika e njëmbëdhjetë: 11.** .Propozim Vendim për miratimin e planit zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: fjalën e kaloj Drejtoreshës Flutura Avdiu**
Bazuar në obligimet ligjore që përcaktohen në Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Komuna e Gllogocit ka filluar me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës.

Procesi i hartimit të PZHK-së ka filluar me vendimin për hartimin e PZHK-së marrë nga Kuvendi i Komunës së Gllogocit me datë 31.01.2018, në të cilën bartës i procesit të hartimit të PZHK-së është përcaktuar Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Për të udhëhequr procesin e planifikimit në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse, komuna ka themeluar dy mekanizma:

Ekipin Komunal për Planifikim (EKP) - të përbërë nga të gjitha drejtoritë e komunës së Gllogocit (Drenasit). Ekipi Komunal i Planifikimit ka shërbyer si platformë për të mbledhë informata nga të gjitha drejtoritë dhe kompanitë publike në komunë, si dhe për të dhënë kontribut në përmbajtjen e PZHK-së në të gjitha fazat e hartimit të tij. Për më shumë EKP ka shërbyer për të harmonizuar kërkesat dhe projektet të të gjithë sektorëve në komunë. Ekipin Këshillues të Komunitetit (EKK) – të përbërë nga të gjitha komunitetet në komunën e Gllogocit (Drenasit). Anëtarët e EKK-së janë përfaqësues të shoqërisë civile, të rinjëve, grave, të moshuarve, personave më aftësi të veçanta, bizneseve, komuniteteve fetare dhe kryetarë të bashkësive lokale. EKK ka shërbyer si urë lidhëse në mes të komunës dhe qytetarëve të komunës. Detyrë primare e EKK-së ka qenë komunikimi me qytetarë rreth përmbajtjes së PZHK-së në faza të ndryshme të hartimit. Procesi i hartimit të PZHK-së ka kaluar në katër faza kryesore siç janë: profili, vlerësimi i gjendjes ekzistuese, koncepti i zhvillimit hapësinor, dhe prioritetet strategjike me planin e veprimit. Të gjitha fazat janë përcjellur me pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe akterëve tjerë relevant dhe me mbajtjen e punëtorive për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028. Për të vazhduar me procedura të mëtutjeshme për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal për periudhën kohore 2020-2028, bazuar dhe në nenin 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 dhe nenit 20 të Ligjit Nr .04/l-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 05/2014 për pjesëmarrjen e publikut në Planifikimin Hapësinor, neni 4 paragrafi 3 pika 3.1, neni 7 paragrafi 2 dhe 3, nenit 8, 10, 12, është miratuar vendimi për shpalljen në shqyrtimin publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028. Pas miratimit të vendimit për shpalljen në shqyrtim publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit për periudhën 2020-2028, Komuna e Gllogocit ka shpallur njoftimin publik në të cilën janë njoftuar qytetaret se do të bëhet hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimin publik të Projekt- Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028.

Me datë 05 shkurt 2020, Komuna e Gllogocit ka hapur Shqyrtimin Publik për Projekt Planin Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028, shqyrtimi publik ka zgjatur 30 ditë nga dita e hapjes, në mënyrë që të kontribuohet në dhënien e vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike: pzhkdrenas@gmail.com, po ashtu duke pasur dhe mundësinë për qasje në versionin digjital të dokumentit të PZHK-së në vegzen elektronike https://kk.rks-gov.net/gllogoc/.
Pas përfundimit të afatit ligjor për shqyrtim publik të Projekt Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028, Ekipi Komunal për Planifikim (EKP), Ekipi Këshillues i Komunitetit (EKK), ekspertet e kompanisë hartuese të Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit, ekspertet e GIZ-it gjerman, kanë analizuar të gjitha kërkesat vërejtjet, sugjerimet nga ana e qytetarëve dhe në bazë të arsyeshmërisë dhe mbështetjes ligjore janë inkorporuar në Planin Zhvillimor Komunal të Gllogocit për periudhën 2020-2028. Pas inkorporimit të komenteve, vërejtjeve dhe sugjerimeve lidhur me vlerësimin profesional nga ana e Divizionit të Planifikimit Hapësinor, është dorëzuar Kërkesa për miratimin përfundimtar të Projekt- Planit Zhvillimor Komunal të

Gllogocit 2020-2028, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, në të cilën është marr Vendim për dhënien e Pëlqimit për Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028. Falënderim i veçantë për kontribuuesit e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028, Ekipin Komunal për Planifikim, Ekipin Këshillues të Komunitetit, ekspertet e kompanisë hartuese të PZHK-së, ekspertet e GIZ-it gjerman, Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, duke i'u ftuar të gjithëve në miratimin e këtij dokumenti të planifikimit hapësinor, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj,** i ftoj të votojnë , pra përkrahet në mënyrë unanime edhe kjo pikë.

**Hapim** diskutimin për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës: *12* Draft - Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023.

**Fjalën ja kaloi drejtorit për Financa Shyqyri Bublaku** – sa i përket Kornizës afatmesme buxhetore ,kësaj i ka parapri qarkorja Buxhetore e cila është lëshuar nga Ministria e Financave. Kjo Qarkore do të jetë e para në serinë e qarkoreve që do të sigurojnë informata për komunat lidhur më zhvillimin e procesit buxhetor komunal.Çdo individ apo familje, i planifikon shpenzimet të bazë të mjeteve që ka në dispozicion, apo një familje e llogarit koston e jetesës së saj sipas një buxheti-të hyrat që ka dhe të cilat mund t'i shpenzojë për gjërat elementare sikur se janë të ushqyerit, veshmbathja, pagesa për qira, shpenzime komunale, argëtimi, rekreacioni, etj. Në të njëjtën mënyrë edhe komuna i planifikon shpenzimet e saj në varësi të buxhetit që harton dhe ka në dispozicion. Ajo planifikon se sa nga të hyrat e saj do të shpenzohen për nevoja të ndryshme të komunës si për shembull, për pagat e të punësuarve në sektorin publik, për shpenzime operative dhe shpenzime kapitale. Ndryshe nga buxheti i individit-familjes, buxheti i komunës planifikohet për një periudhë të caktuar që quhet „viti buxhetor". Ky vit përbëhet nga 12 muaj dhe sipas standardeve të vendosura në vendin tonë është i njëjtë me vitin kalendarik, pra fillon më 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor. Buxheti është një plan i të hyrave dhe shpenzimeve për një periudhë të caktuar kohore në të ardhmen.Buxheti i komunës mbushet nga Grantet e Qeverisë (granti i përgjithshëm, granti specifik për arsim dhe granti specifik për shëndetësi); të Hyrat nga Burimet Vetanake (tatimi në pronë, taksa dhe ngarkesa, të hyra nga pasuria, gjobat nga trafiku dhe gjykatat, etj.) dhe të Hyrat nga palët e treta. Indikatorët që përdoren për alokimin e **Grantit të Përgjithshëm** në komunë janë:

-Numri i popullsisë llogaritet (89%);

-Përmasat gjeografike të komunës (6%);

-Numri i popullsisë pakicë në komunë (3%);

-Komunat ku shumica e popullsisë së të cilëve përbëhet nga pakicat kombëtare (2%)

**Granti Specifik për Arsim**, trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë parasysh këto elemente:

-Numri i nxënësve të regjistruar për vitin shkollor përkatës;

-Raporti nxënës mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm.

**Granti Specifik për Shëndetësi**, kriteret e aplikuara për ndarje të grantit specifik të shëndetësisë janë:

-Vizita për kokë banori;

-Shërbime për kokë banori;

-Kosto mesatare për vizitë.

Projeksionet e THV-ve (të hyrat vetanake) për vitet 2021-2023, bazohen në të hyrat e arkëtuara gjatë viteve paraprake dhe ato të arkëtuara në pjesën e parë të vitit aktual.

Komuna duke u bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023 të Qeverisë së vendit, Qarkoren Buxhetore 2021/01-M.F, Qarkoren Buxhetore Interrne 2021/01 dhe analizat e të Hyrave nga Burimet Vetanake, planifikon këtë kornizë buxhetore sipas viteve dhe sektorëve kryesor:

**Tabela 1. Buxheti total i komunës sipas sektorve dhe viteve, shprehur në euro.**

| **Të hyrat sipas sektorve** | **Aktuali 2020** | **Projeksioni 2021** | **Projeksioni provues** | |
|---|---|---|---|---|
| | | | **2022** | **2023** |
| Sektori i Përgjithshem | 7,351,549 | 7,169,887 | 7,539,731 | 7,962,939 |
| Sektori i Arsimit | 7,152,418 | 6,472,573 | 7,039,890 | 7,070,544 |
| Sektori i Shëndetësisë | 1,986,376 | 2,084,614 | 2,939,945 | 2,956,474 |
| **Gjithsej:** | **16,490,343** | **15,727,074** | **17,519,566** | **17,989,957** |

**Punësimi**: Në parim nuk do të ketë rritje të punësimit në sektorin publik, përveç kur ka një vendim të qartë për nevojën e punësimeve të reja.

**Pagat dhe Mëditjet**: Kategoria e shpenzimeve për paga dhe mëditje historikisht ka përfaqësu pjesën më të madhe të shpenzimeve rrjedhëse dhe gjithashtu planifikohet që përgjatë periudhës planifikuese trendi i njëjtë të vazhdoj.

**Mallra dhe Shërbime**: Më qëllim të racionalizimit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, si dhe përfshirjës së iniciativave të reja të cilat në vete bartin kosto shtesë për buxhet, në këtë kategori është planifikuar të mbajnë pjesëmarrjen e njëjt në buxhet me vitet paraprake, për të shënuar një rritje të vogël vetëm në vitin 2021.

**Shpenzimet e Shërbimeve Komunale**: Pritet të kenë një rritje të lehtë vjetore për gjatë periudhës afatmesme, krahasuar më vitin aktual (2020) e cila rritje vjen si rezultat i shtimit të shpenzimeve për objekte të reja.

**Subvencionet-Transferet**: Kjo kategori ekonomike e shpenzimeve planifikohet të ketë rritje si rezultat i akomodimit të iniciativave të reja, sidomos në fushën e Sektorit të Bujqësisë.

**Shpenzimet Kapitale**: Për periudhën planifikuese (2021-2023) shpenzimet kapitale planifikohet të kenë një rritje të konsiderushme, pasi që shpenzimet rrjedhëse do të jenë të kufizuara, dhe Granti i Përgjithshëm do të ketë ndikimin e drejtpërdrejt në rritjen e masës buxhetore për këtë kategori. Mjetet e planifikuara për këtë kategori do të shpërndahen në projekte kapitale të cilat janë të bazuara në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal, e të cilat projekte kanë të përgatitur projektin zbatues dhe se do të kenë masë të mjaftushme buxhetore. Bazuar në planin komunal të bashkëfinancimit sektorjal me ministritë e linjës dhe donatorët, shpenzimet kapitale pritet të kenë rritje të konsiderushme. Në totalin e shpenzimeve kapitale edhe gjatë periudhës së ardhëshme trivjeqare investimet më të mëdha pritet të jenë në infrastrukturë, përafërsisht 65.32%, për të vazhdu më arsimin më 11.09%, shëndetësia më 7.66%, shërbimet publike më 6.81%, kulturë, rini dhe sport më 4.50%, pjesa tjetër (4.62%) në sektorët tjerë.

Lista e projekteve kapitale është pjesë përbërse e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB-i) 2021-2023, e cila do të plotësohet dhe ndryshohet gjatë procesit buxhetor dhe në fundë të procesit do të aprovohet në Kuvendin e Komunës.

Në aspektin sektorial (pjesëmarrja në shpenzime) Sektori i Arsimit planifikohet të merrë pjesë në buxhet 41.16%, Sektori i Përgjithshëm 45.59%; ndërsa Sektori i Shëndetësisë më 13.25%. Grantet specifike për Arsim dhe Shëndetësi do të përdoren vetem për këta dy sektorë, ndërsa Granti i Përgjithshëm do t'i mbulojë shpenzimet e sektorëve tjerë.

**Vehbi Berisha**-unë vëtëm deshta të bëj një pyetje nuk deshta të diskutoi,pyetja ime është për listën e projektëve,projekti me nr 120 ku janë paraparë të këtë një kufizim të shumës prej 20.000 €,dëshiroj të di a janë përfshi këtë dmth edhe kërkesat që janë bërë të fushat sintetike ,a mundemi me këto 20.000€ me I mbulu shpenzimet të cialt do të krijohen të fusha sintetike, për hjekejen e rrethojave për shkak se shikuesit nuk mund të përcjellin lojen sepse rrethoja është shumë e lart, ne e dim që tek fusha sintetike një pjes e madhe e klubeve të futboolit I zhvillojne lojrat dhe ka qenë kërkes e shkikuesve për me u hiq rrethojat,sepse po pëngojn në shikim e ndeshjes, po ashtu tek palestra sportive ka problem me kulm që rrjedh uji a mundemi me ketë buxhet me saju edhe këtë problem,e pash diku në list për paisje 5000€ për matjen e cilësis se ajrit me sa di unë agjensioni në kuadër të ministris se mjedist dhe planifikimit hapsinor është përgjegjes për këtë se di si komunë a mundemi në me bler paisje të tilla sepse duhet me pas edhe zyratr të cilet janë të qertifikuar për ate punë .

**Drejtoresha Për Kultur Rini dhe Sport Shqipe Zogu**-sa i përket projektit që e specifikuat ju renovimi i objekteve ky projekt ka qene edhe në vitin e kaluar edhe këtë vit është duke u zbatuar për fat të keq pandemia 5% të këtij buxheti prej 30.000€ na e ka marr për këtë vit pra është 28.500 ne jemi duke specifikuar nevojat më emergjente të fushës sintetike e që ka të bej me kulmin ju e dini që tri here radhazi erërat e kanë hjek pjesërisht kulmin dhe vazhdimisht po na duhet me inetervenu aty kështu që me këto 28.500 do të tentojmë të rregullojmë gjithë sistemin e kulmit pastaj edhe sistemin e hidros sepse është edhe një telashe edhe me ujin,sa i përket rrethojave ne i kemi para parë për vitin e ardhshëm këtë kod buxhetor pra heqjen e rrethojave,vazhdimin e tribunave dhe shqyrtimin e mundësisë edhe për një palë tribuna tjera por kjo do te mbetet me kohë ndërsa sa i përket renovimit të palestrës është një problem shumë i madh aty ne bashkërisht me kryetarin jemi munduar ta zgjidhim përveç anës gjygjesore kemi aplikuar tek fondi për efiqjenc të Kosovës ku shpresojmë qe ta fitojmë këtë projekt dhe të rregullohet palestra sportive,nëse nuk arrijmë ta fitojmë atëherë është e mjaftueshme edhe kjo pjesa e 20.000€

**Vehbi Berisha**-kryetar desha të pyes a e kanë bërë pranimin teknik te fushës sintetike?
Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- pranimi teknik i fushës sintetike është bërë para se me ardh unë në pushtet 2015 prandaj ne i kemi këto probleme përkundër asaj ne e kemi detyre kompaninë e cila i ka mbaru punimet me rregulla kulmin të cilin po e hjek era, e kemi edhe komunën e cila ka probleme gjithashtu me kulmin që rrjedh në te gjitha anët, por besoj që ne do ti sanojmë këto probleme me rastin e vazhdimit të punimeve edhe në katin e tret.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**-hodhi në votim pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës ,edhe kjo pikë e rendit të ditës kalon në mënyrë unanime.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj,** hapi diskutimin për pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës: **13Propozim Vendim për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrave.**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: fjalën e kaloj Drejtoreshës Flutura Avdiu-** Komisioni Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës duke pasur parasysh interesin ekonomik të komunës së Drenasit, Planin Zhvillimor Komunal, dhe Planin Rregullues Urban Komunalë, ka bërë Rekomandimin Nr. 01-462-20469, të datës 16.06.2020 për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastra.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës 12-Nr. 400-23049 të datës 02.05.2019, është formuar Komisioni Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në përbërje prej pesë anëtareve.

Në mbledhjen e mbajtur me datë 02.06.2020, anëtaret e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, bazuar në Listën 01-Nr.030--73863 të ngastrave kadastrale sipas zonave kadastrale në pronësi të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për këtë vit të publikuar me datë 30.12.2019, pas diskutimeve, anëtaret e komisionit shqyrtuan, dhe vendosen të propozojmë disa parcela kadastrale të bashkohen e disa të ndahen, me qëllim të ndikohet në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë, dhe për të vazhduar me procedura të mëtutjeshme, propozuan ndarje dhe bashkim të parcelave kadastrale si në vijim:

1.Parcela kadastrale Nr.202-0 zona kadastrale Komoran, propozohet që të bëhet ndarja e parcelës kadastrale me sipërfaqe S=0.37.00 ha.

Ndarja e kësaj parcele propozohet të bëhet me qëllim që shtrati i Lumit të ndahet nga parcela 202-0 dhe shtrati i lumit të këtë parcelën e ndarë sipas komesacionit.

2. Parcela kadastrale 1-5, 1-6, 1-7, propozohet bashkimi i parcelave kadastrale me pjesën e parcelës 1 dhe ndarja e një parcele të re në zonën kadastrale Komoran me sipërfaqe S=1.12.79 ha.

3. Parcela kadastrale 4-100 zona kadastrale Komoran, propozohet bashkimi i parcelës me sipërfaqe S=0.02.00 ha dhe ndarja e parcelës kadastrale në mënyrë që të këtë qasje në rrugë publike, dhe të krijohet një parcelë e re me sipërfaqe S=0.32.66 ha.

4. Parcela kadastrale 4-85, 4-86, propozohet bashkimi i parcelave kadastrale zona kadastrale Komoran, me sipërfaqe S=0.20.00 ha, me qëllim të krijohen kushte me të përshtatshme për investitoret dhe të ndikohet në rritjen e zhvillimit ekonomik të parcelës kadastrale.

5. Parcelat kadastrale 704-0, 705-0, 706-0, 707-0, 708-1, 708-2, 709-0, 710-0 dhe 711-0, propozohet ndarje dhe bashkim i parcelave kadastrale.

Ndarja e parcelës kadastrale 708-0, 709-0 dhe 710-0 për arsye se në një pjesë të këtyre parcelave është realizuar projekti i Ndërtimit të shtratit të lumit Vërboc. Pas ndarjes së parcelave kadastrale të lartë cekura të bëhet bashkimi i parcelave 704-0, 705-0, 706-0, 707-0 dhe të krijohet një parcelë e re me sipërfaqe të përafërt S=1.86.00 ha zona kadastrale Gllogoc.

6. Parcela kadastrale 503-1, 503-2 dhe 502-0, propozohet bashkimi i parcelës zona kadastrale Gllobar, dhe krijimi i një parcele të re me sipërfaqe të përafërt S=0.68.63 ha me qëllim të krijohen kushte me të përshtatshme për investitorët dhe të ndikohet në rritjen e zhvillimit ekonomik të parcelës kadastrale.

7. Parcela kadastrale 150-1, 150-3, zona kadastrale Arllat, propozohet të bëhet bashkimi dhe ndarja e parcelës me sipërfaqe S=0.43.58 ha për arsye se në këtë parcelë është e ndërtuar autostrada M9.

Bashkimi dhe ndarja e parcelave kadastrale, bëhet duke pasur parasysh interesin ekonomik të komunës së Drenasit, Planin Zhvillimor Komunal, dhe Planin Rregullues Urban Komunalë.

Andaj, duke u bazuar në nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës përcaktohet se për Rregullimin e pronës nga komuna dhe duhet ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, duke marr vendim Kuvendi i Komunës.

Bashkangjitur gjeni Rekomandimin Nr. 01-462-20469, të datës 16.06.2020, të Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës. Skicat e parcelave të propozuara për bashkim dhe ndarje.

Fletët poseduese të parcelave të cekura me lartë.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj,** i ftoj të votojnë ,përkrahet me **21 vota Për, 3 Abstenime , Kundër 0.**

**Hapi diskutimin** për pikën e katërmbëdhjetë të rendit të ditës: *14.* Propozim Vendim për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive, në pronën komunale, në parcelën

**Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport Shqipe Zogu**-para së të hidhet në votim kërkoi nga ana juaj që ta aprovoni edhe një plotësim ndryshim,se është një gabim teknik të parcela në Zabel të Epërm nuk është parcela 00235-0 ,por është parcela 0068-0 sipërfaqja është ë njëjtë 2500m , zona kadastrale e njëjte vetëm numri i parcelës duhet te ndërrohet . Dhe sa për informim DKRS për ndërtimin e këtyre dy fushave ,dhe renovimin e atyre ekzistuese i ka buxhet 83.600€

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj,** e hodhi në votim këtë pikë të rendit te ditës me ndryshime, dhe votohet në mënyrë unanime.

**Kalojmë te pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës: 15. Propozim Vendim për ndryshimin e anëtarëve të KKSB-së.**
Më këtë propozim vendim kërkohet zëvendësimi i këtyre anëtarëve të KKSB-së:

1. Z. Tafil Halilaj, zëvendësohet me Muhamet Gjoka ( Drejtoria e Arsimit),
2. Z. Xhavit Bytyqi, zëvendësohet me Arben Haziri (KKP),
3. Z. Armend Garaj, zëvendësohet me Muhamet Ramadani ( KLSP-ja Komoran).

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-edhe pika e pesembedhjet e rendit të ditës votohet në mënyre unanime**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj,** hapi diskutimin për pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës: 16. **Të ndryshme.**

Sokol Bylykbashi –e kam një pyetje rreth kioskave që po largohen, siç është kjo afër komunës, pse po largohen a është në pyetje ndonjë përfundim i kontratave apo çfarë është në pyetje?

**Drejtori i Inspekcionit Milaim Hajdari**-është e vërtet që këtë vit kemi largu tri kioske montazhe të cilat nuk kanë pas leje dhe pas urdhrit për ekzekutim janë larguar vet.

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi si të mbyllur seancën.
***Mbledhja përfundoj rreth orës: 11: 05 min.***

**Procesmbajtëse:**
**Zahrie Podrimqaku Subashi**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Labinot Halilaj**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**Zyra e Kuvendit**

**Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 24. 07 .2020, si vijon:**

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K.P.F-ca se kemi një pika shtesë në rendin e ditës : Raporti Financiar i Zhvillimit të Buxhetit Janar Qershor 2020.
Të gjithë anëtaret e K.P.F-ca u pajtuan që të futen edhe kjo pika shtesë në rendin e ditës, dhe u aprovua në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët rendi i ditës me:
**Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 22.06.2020.
**- Votuan 06,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***

2. Propozim Vendim për shpalljen e Lokalitetit të Boshtrës ( FORSYTHIA EUROPEA) në zonën e Goleshit- Fshatin Sankoc në Kategorinë- Monument i Natyrës, (e plotësuar).

**- Votuan 06,*vota Për, Kundër: 0, dhe Abstenim: 3***

3. Propozim Vendim për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028, (e plotësuar).

**Votuan 06,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***

4. Njoftim rreth përfundimit të kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit .
**Edhe kjo pikë e rendit të ditës kaloj për Kuvend.**

5. Propozim Vendim për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale në Komunën e Drenasit .
**Votuan 06,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***

6. Propozim Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.12-353-22880,të datës 29.06.2020 për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive, në pronën komunale, në zonën kadastrale në Abri e Epërme dhe në zonën kadastrave në Zabel i Epërm.
**Votuan 06,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***

7. Propozim Vendim për këmbimin e parcelave në zonën kadastrave në Baicë.
**Votuan 06,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***

8. Propozim Vendim për lirim nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2020.
**Votuan 06,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***

9. Propozim Vendim për caktimin e Lokacioneve për ndërtimin modernizimin dhe kompletimin e infrastrukturës përcjellëse të studionit të qytetit ''Rexhep Rexhepi" në Poklek të Ri.
Në këtë pikë Kryetari e sqaroi rreth stadionit se kam ju sjellë propozimin edhe për parcelën 120/0, private e cila na duhet ta blejmë që ti shtohet stadionit ku në këtë mbledhje nuk e kemi përfshirë.
Fjalën e mori Burim Bujupi i cili propozoi që të përfshihet si pikë shtesë në këtë mbledhje dhe e cila u përkrah në mënyrë unanime të hun si pikë shtesë.
**Votuan 06,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***

10. Propozim Vendim për caktimin e Lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e Çerdhes në Komoran.
**Votuan 06,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***

11. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm Publik për kthimin e pronave të cilat janë nën menaxhimin e AKPS-së, në zonat Kadastrale : Qikatovë e Re, Terstenik,Poklek , Korroticë e Poshtme, Zabel i Poshtëm, Komoran dhe Sankoc.
**Votuan 06,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***

12. Raporti Financiar i Zhvillimit të Buxhetit Janar Qershor 2020.
**Rekomandohet për Kuvend.**

13. Për Shpalljen e interesit të Përgjithshëm Publik të pjesës së ngastrës kadastrave 120/0, për zgjerimin, modernizimin dhe kompletimin e infrastrukturës përcjellëse të Stadionit në qytetin e Drenasit " Rexhep Rexhepi" në Poklek të Ri.
**Votuan 06,*vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00***

14. Të ndryshme.

**Pasi spati diskutime mbledhja përfundoi në ora 11: 30.**

Kryesuesi i Kuvendit
Labinot Halilaj

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Gllogocit**
Zyra e Kryetarit

**01-Nr** 633/01-24187 **dt.** 09.07 **2020**

Në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyres Nr.03/L-233, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.85 e datës 09 nëntor 2010, nenit 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 04 qershor 2008, nenit 72 paragrafi 1 pika (h) të Statutit të Komunës së Gllogocit, Kuvendi i Komunes së Gllogocit, në mbledhjen e mbajtur më _________2020, të miratoj këtë:

**PROPOZIM VENDIM**

**PËR SHPALLJEN E LOKALITETIT TË BOSHTRES *(FORSYTHIA EUROPEA)* NË ZONËN E GOLESHIT- FSHATIN SANKOC NË KATEGORINË - MONUMENT I NATYRËS**

**Neni 1**

Me këtë Vendim shpallet nën mbrojtje Lokaliteti i Boshtres (*Forsythia europea*) në zonën e Goleshit – fshatin Sankoc të Gllogocit, në kategorinë Monument i Natyrës (këtu e tutje: Monument i Natyrës).

**Neni 2**

Sipërfaqja e Zonës së mbrojtur të Monumentit të Natyrës në Komunën e Gllogocit është 38.42 hektare, ndërsa paraqitja hartografike me përmasa 1 :25000 paraqitet në Shtojcen e bashkëngjitur të këtij Vendimi.

**Neni 3**

Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

a) Shfrytëzimi i resurseve natyrore,
b) Prerja e trungjeve dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme,
c) Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur,
d) Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur,
e) Hedhja e mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur,
f) Aktivitete tjera të cilat mundë të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

Në Monumentin e Natyrës lejohet:

Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e

R.U

gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

**Neni 4**

Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Gllogocit përmes Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe është e detyruar që:

a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes,
b) Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës munden ta shkatërrojnë ose t`i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,
c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

**Neni 5**

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

**Neni 6**

Ky Vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Gllogocit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

# HARTA: LOKACIONI I ZONËS "BOSHTRA"




| KOMUNA | SIP_HA |
|---|---|
| GLLOGOC | 38.42 |
| FUSHË KOSOVË | 109.99 |
| LIPJAN | 69.00 |

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna Gllogoc**
Zyra e Kryetarit

**01-Nr** 400/01-247 90 **dt.** 09.07 **2020**

Në bazë të nenit 58 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 10 paragrafi 2 nen paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Vendimit Nr.632 për dhënien e Pëlqimit për Miratim të Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028 nga Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, të inicuar dhe hartuar nga Komuna e Gllogocit. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës, të miratoj këtë:

## PROPOZIM VENDIM
## PËR MIRATIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË GLLOGOCIT 2020-2028

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Gllogocit të miratoj propozim vendimin për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit për periudhën 2020-2028.

Neni 2

Pjesë përbërese e këtij vendimi është Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit për periudhën 2020-2028.

Neni 3

Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028, është hartuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit në koordinim me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit për periudhën 2020-2028, përgjegjëse është Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gllogocit.

Neni 5

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij propozim vendimi duhet të jetë në gjuhë zyrtare dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Gllogocit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së dhe pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVA
Qeveria e Kosovës · Vlada Kosova · Government of Kosova
Ministria e Zhvillimit Ekonomik · Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
Ministry of Economic Development

| | | | |
|---|---|---|---|
| Njësia Org / Org. Jedin / Org Unit | 02 | Nr Prot / Br. Prot / Prot No | 632 |
| Nr i fletëve / Broj stranica / No. pages | 4 | Data / Datum / Date | 29.06.20 |

PRISHTINË/A

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria -Vlada - Government***

***Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit***
***Ministarstvo Ekonomije i Sredine***
***Ministry of Economy and Environment***

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm /Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary*

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 19.06.2020 |
| **REFERENC-Ë:** | |
| **PËR/ZA/TO:** | Flutura Avdiu, Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Gllogocit |
| **CC:** | Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Gllogocit |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | |
| **NGA/OD/FROM:** | Mentor Sylmeta, U.D. Sekretarit të Përgjithshëm i MEA-së |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Vendim për dhënien e pëlqimit për miratim të "Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028" sipas kërkesës me datë 02.06.2020 dhe numër të protokollit 2505/20** |

E nderuara Flutura Avdiu,

Bazuar në *Kërkesën për pëlqim* të *projekt-"Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028"* nga Flutura Avdiu, Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gllogocit të datës 02.06.2020 me nr. të protokollit 2505/20, Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim ne kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, duke marrë për bazë "Vendimin për dhënie të Pëlqimit në Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të projekt-Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit" Vendimi nr. 19/5918/1-792/DMMU të datës 11.10.2019 (MMPH/DMM), ka shqyrtuar projekt- "Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028", sipas Ligji Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor dhe vendosi të sjellë vendimin e bashkangjitur në këtë shkresë.

Me respekt,


Adresa: ish pallati i mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 200 32 307; +381 38 200 32 245
http://mia-ks.org E-mail: zsp.mia@ks-gov.net

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, duke u bazuar nenin 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare,Nr.7,01 Mars 2019), nenit 17 paragrafin 5 dhe 6 të Rregullores Nr.02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, (Gazeta Zyrtare,Nr.1/18 prill 2011), si dhe neni 9 (paragrafi 2, nën paragrafi 2.3 Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nxjerrë:

# VENDIM

## Për dhënien e Pëlqimit për miratim të Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028

Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit pas verifikimit të përputhshmërisë së projekt-"Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028", me "Planin Hapësinor të Kosovës-Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+" dhe Normat teknike të planifikim hapësinor, jep pëlqim për miratim të "Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020 – 2028".


Adresa: ish pallati i mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 200 32 307; +381 38 200 32 245
http://mia-ks.org E-mail: zsp.mia@ks-gov.net

## Arsyetim

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Gllogocit me shkresë zyrtare të datës 02.06.2020 me nr. prot 2505/20, kërkon nga MEA/DPHNB pëlqim për miratim të Projekt – "Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028", sipas procedurës ligjore pas shqyrtimit publik të hapur më datës 05.02.2020 në kohëzgjatje prej 30(tridhjetë) ditëve .

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit pas shqyrtimit dhe vlerësimit të projekt-"Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028" dhe dokumentacionit përcjellës si Raporti i Vlerësimit Strategjikë Mjedisor dhe Raporti nga shqyrtimi publik konstaton se ky dokument:

- I plotëson kushtet ligjore të parapara me Ligjin Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor mbi procedurat e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor;
- Është në pajtim me nenin 15 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor;
- Është në pajtim me nenin 20 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor;
- Është në përputhshmëri me "Planin Hapësinor të Kosovës -Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+";
- Është i bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH–NR.11/20015 Mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal.
- Është i bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH –NR.08/20017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Komuna e Gllogocit shtatë (7) ditëve pas miratimit nga Kuvendi i Komunës të "Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028" dorëzon dokumentin e planifikimit hapësinor në Departamentin për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim ne kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, me qëllim të sigurimit të saktësisë dhe kompletimit të të dhënave të përfshira në Bazën e të dhënave të Planifikimit Hapësinor, sipas neni 11. Paragrafi 1. nenpararagrafi 1.11. i Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor.

"Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028" duhet të dorëzohet para se të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Komunës për miratim të "Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028", në kuptim të nenit 81 të Ligji Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale .


Adresa: ish pallati i mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 200 32 307; +381 38 200 32 245
http://mia-ks.org E-mail: zsp.mia@ks-gov.net

**P.S. Projekt-"Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028" të përkthehet në gjuhën serbe ashtu si parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 5.1.).**

- **Në kuptim të neni 21. të Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, me Planin Zhvillimor Komunal nuk mund të lëshohen Kushtet ndërtimore!**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

U.D. Sekretarit të Përgjithshëm

Mentor Sylmeta

Vendimi i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Kabinetit të Ministrit;
3. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
4. Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim;
5. Inspektoratit të MMPH-së;
6. Arkivit të MMPH-së.



Adresa: ish pallati i mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 200 32 307; +381 38 200 32 245
http://mia-ks.org E-mail: zsp.mia@ks-gov.net

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Zyra e Kryetarit

**01 Nr** 360/03-26084 **dt.** 17. 07. **2020**

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 17.07.2020 |
| **PËR/ZA/TO:** | Asambleistët e Kuvendit të Komunës së Drenasit |
| **NGA/OD/FROM:** | Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Njoftim rreth përfundimit të kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit |

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Drenasit,

Duke pasur për bazë Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, respektivisht nenin 23 paragrafin 1 dhe 2, ju njoftoj si në vijim:

Komuna e Drenasit gjatë viteve paraprake ka lidhur disa kontrata për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cilave kontrata ju ka skaduar afati i shfrytëzimit, andaj ashtu siç me obligon legjislacioni në fuqi po ju njoftoj me atë pronë:

Kontrata e lidhur me datë 25/03/2009, me nr.955-1922, me sipërfaqe 0.20.00 ha, e cila është pjesë e ngastrës nr.244/4, në Zonën Kadastrale në Komoran, ka skaduar me datë 25.03.2019, ku shfrytëzues i përkohshëm (10 vite) ka qenë Kastriot Xheladin Gashi nga Komorani.

Duke mos pasur asnjë mundësi të vazhdimit të tyre, sepse një gjë të tillë e ndalon neni 23 paragrafi 1 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i cili thotë: Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës, në këtë formë duke mos lejuar asnjë vazhdim të asnjë kontrate, pa marr parasysh investimet e bëra nga personat që e kanë pasur në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale.

Andaj, prona e lartcekur, edhe në bazë të listës së veçantë, ashtu siç e parasheh neni 13 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nuk është paraparë që të ipet në shfrytëzim për këtë vit, po ashtu kjo parcelë do të vlerësohet nga ana e Komunës së Drenasit, se e njëjta a do të ipet në shfrytëzim apo do të shfrytëzohet për interesat e Komunës së Drenasit, gjithnjë në përputhje me planin zhvillimor ekonomik të Komunës sonë.

Ju faleminderit!

**Republika e Kosovës**
**Komuna e Drenasit**
**Zyra e Kryetarit**
**Nr.01-_352/05- 26091_ dt.17.07_____.2020**

Në bazë të nenit 58 par. 1 pika *h* të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 paragrafi (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 11, të nenit 12, pika12.1 dhe pika 12.2, nenit 14 pika 14.1 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë______________.2020 të miraton këtë:

**PROPOZIM-VENDIM**

**Propozim-vendim për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale të Komunen e Drenasit.**

**I.**

Të miratohet vendimi për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në pronë komunale, në të gjitha zonat kadastrale të Komunës së Drenasit.

**II.**

Qëllimi i këtij vendimi është që të bëhet definimi dhe parcelizimi i të gjitha parcelave kadastrale prone komunale e Komunës së Drenasit, në të cilat ndodhen varrezat.

**III.**

Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë që pas miratimit të këtij vendimi të bëjë implementimin e projektit për mirëmbajtjen e varrezave.

**IV.**

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodozike, kadastrale dhe pronësore, që nevojiten për regjistrimin në RDPP.

**V.**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë e Komunës së Drenasit.

**VI.**

Me këtë Vendim do të njoftohen organet kompetente të Komunës së Drenasit.

**VII.**

Ky vendim hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Drenasit.

**KRYETARI I KOMUNËS:**

**Ramiz Lladrovci**

**Repulika e Kosovës**
**Komuna e Drenasit**
**Zyra e Kryetarit**
**Nr.01-** 353/01. 26097 **dt.** 17 07 **.2020**

Në bazë të nenit 58 par. 1 pika *h* të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 paragrafi (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 11, të nenit 12, pika12.1 dhe pika 12.2, nenit 14 pika 14.1 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë_____________2020 të miraton këtë:

# PROPOZIM-VENDIM

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.12-353-22880, të datës 29.06.2020, për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive, në pronën komunale, në zonën kadastrale në Abri e Epërme dhe në zonën kadastrale në Zabel i Epërm.**

**I.**

Të miratohet propozim - vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.12-353-22880, të datës 29.06.2020, për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive, në pronën komunale, në zonën kadastrale në Abri e Epërme dhe në zonën kadastrale në Zabel i Epërm.

**II.**

Sipas propozim – vendimit të cekur në pikën I, plotësim – ndryshimi nënkupton:

Të ndryshohet propozimi i dytë i nenit I të Vendimit nr.12-353-22880, të datës 29.06.2020, të hiqet parcela e ngastrës kadasatrale nr. 02048-0, me sipërfaqe prej S=2500m$^2$, Zona Kadastrale Abri e Epërme, dhe në vend të saj shënohet parcela kadastrale nr.1817/0, Zona Kadastrale Abri e Epërme.

**III.**

Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit nr.12-353-22880, të datës 29.06.2020, të cekur në pikën II, është bërë pasi që është lëshuar një gabim teknik, ku në vend të parcelës kadastrale nr.1817/0 në ZK Abri të Epërme, është shenuar parcela kadastrale 2048/0 po ashtu ZK Abri e Epërme.

**IV.**

Ky vendim shfuqizon propozimin e dytë të nenit I të Vendimit nr.12-353-22880, të Kuvendit Komunal të Drenasit, të datës 29.06.2020.

**V.**

Ky vendim hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Drenasit.

**KRYETARI I KOMUNËS:**

**Ramiz Lladrovci**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMBIENTIT / MINISTRASTVO INFRASTRUKTURE I SREDINE / MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315019-01817-0

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 12-353-22880 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 16.07.2020 - 13:25 |
| Komuna / Opština / Municipality: | Gllogoc / Glogovac / Gllogoc |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | ABRI E EPËRME / GORNJE OBRINJE / ABRI E EPËRME |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | Gllogoc / Glogovac / Gllogoc |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70315019-01817-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | 124694 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| BRINJE-BRINJA/BRINJE-BRINJA/BRINJE-BRINJA | | BRINJE-BR[illegible] | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO - KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLLOGOC - MUNICIPALITY GLLOGOC

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 4/Pasnjak 4 Klase/4th Class Pasture | **124694** |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | **Pronë Komunale KK Gllogoc** | KCID0307594 | ABRI E EPËRME / GORNJE OBRINJE / ABRI E EPËRME / | | GLLOGOVC | **1/1** | | |

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova
*Qeveria -Vlada-Government*
*Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit / Ministrastvo Infrastrukture i Sredine / Ministry of Infrastructure and Environment*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOC
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Abri e epërme

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70315019-01817-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 124694 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:6816

Punoi/Obradio/Created:
Data/ Data/Date: 16.07.2020
Koha/ Vreme/ Time: 02:16:37
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note: kerkesa nr.12-353-22880

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtor/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit

Nr.1-03/01-26094 dt.17 07 .2020

Në bazë të nenit 58 par.1 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 paragrafi (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 pargrafi 1 dhe paragrafi 2, nenit 14 paragrafi 1 Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 24 paragrafi 1 dhe 2, si dhe nenit 25 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë_______________2020 të miratoi këtë:

**PROPOZIM–VENDIM**

**Për këmbimin e parcelave në zonën Kadastrale në Baicë**

**I.**

**Të miratohet** propozim – vendimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme private, në pronësi të Ajet (Tafë) Kiqina në zonën Kadastrale në Baicë.

**II.**

Pronat e paluajtshme të cilat do të këmbehen kanë këto karakteristika: parcela kadastrale 1709-0, Zona Kadastrale Baicë, pasuri shoqërore – rrugë, pronë komunale, me sipërfaqe 5397 $m^2$.

Parcela kadastrale nr.896-0, Zona Kadastrale Baicë, pronë private me kulturë Kullosë e klasës 2, me sipërfaqe 1700 $m^2$, me pronarë Ajet (Tafë) Kiqina.

**III.**

Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë, pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e interesit publik të Komunës së Drenasit për planet zhvillimore të komunës, konkretisht projektin e funksionalizimit infrastrukturor - rrugorë në Baicë për banorët e këtij fshati.

**IV.**

Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private

R. U

V.

Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.

VI.

Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.

VII.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike, kadastrale që nevojiten për këmbimin e këtyre parcelave.

VIII.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodozi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Drenasit.

IX.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:

- Skica gjeodezike
- Çertifikatat e pronësisë dhe
- Kopja e planit

X.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe publikimit në ueb-faqen e Komunës.

**KRYETARI I KOMUNËS**

**Ramiz Lladrovci**

## Arsyetim

Propozimi për këmbimin e këtyre parcelave është bërë me qëllim të realizimit të interesit publik të Komunës së Drenasit për projektin e funksionalizimit infrastrukturor, për rregullimin dhe asfaltimin e kësaj rruge, si dhe për realizimin e planeve zhvillimore të komunës.

Pronari i parcelës nr.896-0, Ajet Tafë Kiqina me anë të kërkesës nr.07-070/7611 datë 10.02.2020 i është drejtuar Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ku ka kërkuar që në marrëveshje me Kryetarin e Komunës të bëhet ky këmbim parcelash.

Këmbimet e këtyre parcelave janë të domosdoshme për banorët e kësaj ane, që të bëhet rregullimi i rrugës sipas standardeve infrastrukturore, dhe planeve zhvillimore të Komunës së Drenasit.

Faktikisht rruga të cilën e shfrytëzojnë banorët në përditshmëri kalon nëpër pronën private përkatësisht nëpër parcelën nr.896-0, pronë private e Ajet Kiqinës, andaj është shumë e arsyeshme që të bëhet këmbimi i këtyre parcelave.

Këmbimi do të bëhet në atë mënyrë ku nga parcela nr.896-0 pronë private e Ajet Kiqinës këmbehet sipërfaqja e përgjithshme prej S=736 $m^2$, dhe nga parcela nr.01709-0 pronë komunale po ashtu do ti këmbehet sipërfaqja e njëjtë prej S=736 $m^2$.

Ekipi profesional i Drejtorisë për Gjedoezi, Kadastër dhe Pronë ka dal në vendshiqim dhe ka bërë inçizimin e pjesës së ngastrave kadastrale të shënuara më lartë të cilat do të këmbehen, e për të cilat pjesë janë nxjerrë edhe skicat grafike dhe çertifikatat mbi të drejtat e pronës.

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Plannin*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOVC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Baicë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi / vrsta / Type | Siperfaqja/Povrsina/Area |
|---|---|---|
| P-00896-0 | parcelë/parcela/parcel | 1700.0 |
| AJET TAFË KIQINA | | |

| | | |
|---|---|---|
| P-01709-0 | parcelë/parcela/parcel | 5397.0 |
| PASURI SHOQERORE RRUGË | | |




Shkalla/Razmera/Scale 1: 500

Punoi/ Obradio/ Created:
Data/ Data/ Date: 09.07.2020
Koha/ Vreme/ Time
Nënshkrimi/Potpis/Signature

Shenime/Beleske/Note:

Aprovoi/Odobrio/Aproved : MCO GLLOGOVC direct

Nënshkrimi /Potpis/Signature

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit / Ministrastvo Infrastrukture i Sredine / Ministry of Infrastructure and Environment*

**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY**

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Baicë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70315003-01709-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 5397 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:5762

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 15.07.2020

Koha/ Vreme/ Time: 01:41:48

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO - KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMBIENTIT / MINISTRASTVO INFRASTRUKTURE I SREDINE / MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315003-01709-0

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 07-070/01-7611 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 15.07.2020 - 13:24 |
| Komuna / Opština / Municipality: | Gllogoc / Glogovac / Gllogoc |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | BAICË E ELSHANIT / BANJICA / BAICË E ELSHANIT |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | Gllogoc / Glogovac / Gllogoc |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type | Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type | Zona U/R G/S U/R | Sipërfaqja Površina Area (m²) | Përshkrim Opis Description | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70315003-01709-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | 5397 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|
| DUBRAVA-DUBRAVA/DUBRAVA-DUBRAVA/DUBRAVA-DUBRAVA | | DUBRAVA-DUBRAVA | | |

REPUBLIC OF KOSOVO - GLLOGOC MUNICIPALITY - REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA GLLOGOC - REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA GLLOGOC

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja ($m^2$)<br>Površina ($m^2$)<br>Area ($m^2$) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure | Rrugë E Pakategor/Nekategorisani Put/UncategorizedRoad | | 5397 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | **PASURI SHOQËRORE-RRUGËT** | KCID0301922 | BAICË E ELSHANIT / BANJICA / BAICË E ELSHANIT / | | GLOGOVCI | 1/1 | | |

**Republika e Kosovës**

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit / Ministrastvo Infrastrukture i Sredine / Ministry of Infrastructure and Environment*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Baicë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70315003-00896-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 1700 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:556

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 15.07.2020

Koha/ Vreme/ Time: 01:42:24

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Odobrio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMBIENTIT / MINISTRASTVO INFRASTRUKTURE I SREDINE / MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315003-00896-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **07-070/01-7611** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 15.07.2020 - 13:24 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | Gllogoc / Glogovac / Gllogoc |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | BAICË E ELSHANIT / BANJICA / BAICË E ELSHANIT |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | Gllogoc / Glogovac / Gllogoc |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

